



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtina, on 6 March 2023
Ref. no.: AGJ 2133/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI36/22

Parashtrues

“MATKOS GROUP” SH.P.K

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ. nr. 116/2021 të 28 tetorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga “Matkos Group” SH.P.K, me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Betim Shala, avokat në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [AA. nr. 665/2021] të 30 korrikut 2021 të (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [A. nr. 472/2021] e Gjykatës Themelore në Prishtinë të 17 qershorit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 19 nëntor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përveç, kësaj parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon edhe vendosjen e masës së përkohshme duke theksuar se zbatimi i Aktgjykimit [ARJ. nr. 116/2021] të Gjykatës Supreme do të *“shkaktojë dëm të pariparueshëm material për parashtruesin e kërkesës.”*

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenet 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 mars 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 24 mars 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI. 36/22] caktoi Gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 21 prill 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme, Ministrisë së Ekonomisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE).
10. Më 20 maj 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletë-kthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 27 maj 2022, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletë-kthesën e kërkuar që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar vendimin e kontestuar.

12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës dhe filloi mandatin e tij në Gjykatë.
13. Më 18 janar 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
14. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi, njëzëri që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) që ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021; (iv) të kthej për rishqyrtim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; (v) konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [AA. nr. 665/21] i 30 korrikut 2021, mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Supreme sipas pikës IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi; (vi) refuzoi kërkesën për vendosje të masës së përkohshme.
15. Në përputhje me rregullin 62 (Mendimet konkurruese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim konkurrues, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës është shoqëri tregtare që merret me prodhimin e energjisë elektrike, veprimtari të cilën e ushtron përmes prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralin HC Brezovica, të ndërtuar në luginën e lumit Lepenc. Po ashtu, rezulton se i njëjti ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me ndërmarrjen shtetërore KOSTT për shitblerjen e energjisë elektrike.
17. Parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës, ka zhvilluar veprimtarinë e tij bazuar në vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (në tekstin e mëtejme: ZRRE), e cila në vazhdimësi ka lëshuar vendime të cilat i kanë mundësuar parashtruesit të kërkesës investimin në kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës për hidrocentrale.
18. Më 18 shtator 2020, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (në tekstin e mëtejme: MEA) nxori Vendim për aprovimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës me nr. 5784/18 për leje ujore për HC-Brezovica.
19. Më 26 shkurt 2021, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (në tekstin e mëtejme: GLPS) dhe Organizata GAIA dorëzuan padi në Gjykatën Themelore, kundër MEA-së, me propozimin që të (i) aprovohet padia si tërësisht e bazuar; (ii) anulohet Vendimi i MEA-së për leje ujore për HC Brezovica; (iii) aprovohet kërkesa për masë të përkohshme; (iv) parashtruesi i kërkesës të ndalë ndërtimin e hidrocentraleve dhe strukturave të tyre mbështetëse në Komunën e Shtërpcës, HC Brezovica, HC Shtërpca, HC Viça dhe HC Sharri, deri në njëvendim përfundimtar të gjykatës; si dhe (v) të aprovohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të MEA-së.
20. Më 22 mars 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 472/2021] e aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve dhe shtyu ekzekutimin e vendimit të MEA-së, respektivisht Vendimin për aprovimin e lejes ujore me nr. 5784/18, derisa në një vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësve.
21. Në arsyetimin e Aktvendimit të lartcekur, Gjykata Themelore, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 22 si dhe nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet

Administrative (GZ, numër 82, 21 tetor 2010) (në tekstin e mëtejshëm: LKA), vlerësoi se paditësit/propozuesit kishin ofruar argumente të besueshme, fotografi të protestave të qytetarëve ndër vite, fotografi të dëmtimit të natyrës, raporte të organizatave të ndryshme përkitazi me ndërtimin e hidrocentraleve, të cilat vërtetohnin se ekzekutimi i vendimeve do t'i sillte dëm banorëve të pjesës në të cilën parashihej të operojnë këto hidrocentrale, dëm ky i cili vështirë do të riparohet. Për më tepër, Gjykata Themelore, duke marrë në konsideratë se burimet ujore dhe qasja në ujë të pijshëm dhe për ujitje, cilësia e ujit, ndikimet negative në florë dhe faunë përbënin interes të përgjithshëm shtetëror, konstatoi se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk ishte në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar.

22. Më 26 mars 2022, Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e përfaqësueses së MEA-së, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 472/2021] të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 31 mars 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit parashtrësë që në cilësi të palës së interesuar të hyjë në konfliktin administrativ.
24. Më 13 prill 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 472/2021] të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes së dispozitave të LKA-së dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.
25. Më 17 maj 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr. 472/2021] miratoi si të bazuara ankesat e MEA-së dhe parashtruesit të kërkesës, ndërsa anuloi Aktvendimin [A. nr. 472/2021] e Gjykatës Themelore, duke i kthyer lëndën kësaj të fundit në rigjykim dhe rivendosje.
26. Përmes Aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se Gjykata Themelore nuk kishte vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike si dhe nuk kishte zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të drejtë. Në arsyetimin e Aktvendimit të lartcekur, Gjykata e Apelit theksoi se nuk mund ta pranonte si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që aktvendimi i ankimuar nuk bazohej në fakte vendimtare të qëndrueshme dhe ishte i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga pika i) dhe n) të paragrafit 2 të nenit 182 si dhe neneve 183 dhe 184 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (GZ, numër 38, 20 shtator 2008) (në tekstin e mëtejshëm: LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Për më tepër, Gjykata e Apelit konstatoi se aktvendimi i ankimuar ishte i përfshirë me shkelje thelbësore të neneve 21, 37, 39 dhe 55 të LKA-së sepse parashtruesit të kërkesës nuk i ishte dhënë mundësia që të jetë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, si palë e interesuar.
27. Më 29 maj 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. 472/21] e aprovoi si të bazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për njohjen e cilësisë së palës së interesit. Në po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore detyroi parashtruesin e kërkesës që në afat prej 3 (tri) ditësh nga dorëzimi i vendimit t'i paraqesë gjykatës përgjigje në kërkesën e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit si dhe t'ia dorëzojë të gjitha provat lidhur me çështjen kontestuese.
28. Më 17 qershor 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 472/2021], në rivendosje, e aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve dhe shtyu ekzekutimin e vendimit të MEA-së, respektivisht Vendimin për aprovimin e lejes ujore me nr. 5784/18, derisa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësve.

29. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore u theksua se ishin përmbushur kushtet nga paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të kundërshtuar deri në vendosjen përfundimtare të çështjes. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore vlerësoi se paditësit/propozuesit kishin ofruar argumente të besueshme, fotografi të protestave të qytetarëve ndër vite, fotografi të dëmtimit të natyrës, raporte të organizatave të ndryshme përkitazi me ndërtimin e hidrocentraleve, të cilat vërtetohnin se ekzekutimi i vendimeve do t'i sillte dëm banorëve të pjesës në të cilën parashihej të operojnë këto hidrocentrale, dëm ky i cili vërshtirë do të riparohej.
30. Për më tepër, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të saj vlerësoi se burimet ujore dhe qasja në ujë të pijshëm dhe për ujitje, cilësia e ujit, ndikimet negative në florë dhe faunë përbënin interes të përgjithshëm shtetëror dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen e çështjes në mënyrë përfundimtare ishte në interesin publik dhe nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar.
31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes së dispozitave të LKA-së dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.
32. Më 30 korrik 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 665/21] (i) aprovoi si të bazuara ankesat e MEA-së dhe të parashtruesit të kërkesës; (ii) ndryshoi Aktvendimin [A. nr. 472/21] e Gjykatës Themelore; si dhe (iii) refuzoi propozimin e paditësve GLPS dhe GAIA për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës, respektivisht vendimin për aprovimin e lejes ujore nr. 5784/18, deri në një vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësve.
33. Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktvendimit të saj vlerësoi se Gjykata Themelore gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale kur kishte vendosur që të aprovojë propozimin e paditësve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Në këtë drejtim, duke iu referuar paragrafit 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së si dhe pikave a) dhe b) të paragrafit 1 të nenit 297 të LPK-së, Gjykata e Apelit vlerësoi se paditësit nuk e kishin bërë të besueshëm faktin se cili ishte dëmi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë që iu kanosej në rast të ekzekutimit të vendimit të atakuar, por vetëm përmendnin faktin se me ekzekutimin e vendimit cenohej mjedisi dhe uji i pijshëm, pa paraqitur prova konkrete se në çfarë mase u reduktohej furnizimi me ujë apo cenohej mjedisi.
34. Tutje, Gjykata e Apelit konstatoi se paditësit nuk e kishin bërë të besueshëm faktin se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk ishte në kundërshtim me interesin publik dhe se nuk i shkaktohej dëm palës kundërshtare. Kjo pasi që shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar ishte në kundërshtim me interesin publik pasi që parashtruesi i kërkesës kishte marrë vendimin për lejen ujore, me çka kishte marrë edhe obligimin për shfrytëzimin e potencialit hidroenergjetik sipas kushteve të përcaktuara në atë vendim, në interes publik.
35. Në këtë drejtim, në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit u theksua si në vijim: *"Konkretisht nga vendimi i të paditurës nr. 5784/18-ZSP të datës 18.09.2020 është vërtetuar fakti se pala i interesit juridik "Matkos Group" sh.p.k është pajisur me leje ujore ku ndër tjerash është obliguar të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht të matjeve të niveleve dhe prurjeve të ujit, në profilet përkatëse të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me Lejet Ujore për shfrytëzim të ujit e "nëse për shkak të shfrytëzimit të ujit të hidrocentralit, vije gjer te çrregullimi i regjimit ujqor, gjer te proceset eroduese në shtrat te lumit te*

objekti ujëmarrës te objektit prodhues dhe përgjatë gyp sjellësit e kjo shkakton dëme të çfarëdo karakteri shfrytëzuesi është i obliguar që shkaqet e dëmit ti eliminoj, kurse dëmet ti kompensoj", andaj tënjëjtën provë gjykata e vlerësoj të besueshme pasi që në bazë të këtij vendimi e paditura MEA e ka obligim që, të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të kësaj kompania në lidhje me respektimin e kushteve të marruara nga e paditura dhe në rast se ato nuk respektohen të revokoj lejet përkatëse."

36. Në një datë të paspecifikuar, GLPS dhe GAIA dorëzuan në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktvendimit [AA. nr. 665/21] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe të drejtës materiale.
37. Më 28 tetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ nr. 116/2021] e aprovoi si të bazuar kërkesën e paditësve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, anuloi Aktvendimin [AA. nr. 665/21] e Gjykatës së Apelit dhe la në fuqi Aktvendimin [A. nr. 472/2021] e Gjykatës Themelore.
38. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të lartcekur vlerësoi se Gjykata e Apelit nuk kishte peshuar në mënyrë kumulative të gjitha rrethanat siç përcaktohet me nenin 22 të LKA-së. Në këtë aspekt, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme u theksua se arsyetimi i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit ishte i mangët dhe jo bindës mbi faktet vendimtare dhe nuk përmbante arsye të justifikueshme sipas provave të lëndës. Për më tepër, Gjykata Supreme shtoi si në vijim:

"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit-propozuesit me padi dhe me kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor kanë ofruar dëshmi të besueshme se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur para se të vlerësohet ligjshmëria e tij do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej dhe do të ishte në interes publik shtyrja e vendimit të organit të paditur. Gjithashtu kolegji vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për investim material me ndërtimin e hidrocentralit dhe nëse do të vendosej ndryshe me vendosjen meritore të çështjes do të ishte i vështirë rikuperimi dhe evitimi i dëmeve. Prandaj shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur gjer në vendosjen meritore me vendim përfundimtar, nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi, dhe palës kundërshtare apo palës së interesuar nuk provohet se do të shkaktohet dëm i madh apo i pa riparueshëm. Gjer sa në anën tjetër do të shmangeshin pasojat e mundshme si do që të vendoset meritorisht gjatë vlerësimit të ligjshmërisë në baza ligjore të vendimit të kontestuar me padi nga paditëset, në fund të procesit gjyqësor."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6(E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.
40. Parashtruesi i kërkesës thekson se me zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale, duke dhënë një interpretim restriktiv e arbitrar dhe një arsyetim të pamjaftueshëm, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ nr. 116/2021] i ka cenuar atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës si dhe e ka privuar në mënyrë arbitrare nga prona e tij, e drejtë e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

I. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

41. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se kërkesa e tij përmbushë të gjitha kriteret e pranueshmërisë për zbatimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së në vendimet që kanë të bëjnë me procedurë paraprake, duke pohuar se Gjykata duhet ta pranojë këtë rast për shqyrtim të meritave në bazë të kriterëve të përcaktuara në Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, por edhe rastet e Gjykatës *KI122/17*, parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 18 prillit 2018 dhe *KI195/20*, parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim i 29 marsit 2021.
42. Parashtruesi i kërkesës thekson se është i vetëdijshëm se neni 6 i KEDNJ-së, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe po ashtu, kupton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme për të cilin pretendon se është i përfshirë në shkelje të të drejtave të njeriut nuk iu përkon meritave të rastit, por ka të bëjë me një procedurë paraprake, respektivisht me caktimin e masës së përkohshme. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton se edhe Gjykata Kushtetuese në rastin *KI122/17* ka konstatuar se mund të ketë raste ku procedurat paraprake mund të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile të parashtruesit të kërkesës.
43. Tutje, duke iu referuar rastit *Micallef kundër Maltës*, parashtruesi i kërkesës rikujton konstatimin e dhënë të GJEDNJ-së se “Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i Nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shumë Shteteve Kontraktuese u duhet të përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tej zgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodh që është i barasvlershëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë dhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodh që procedurat për masa provizore dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat “detyrime dhe të drejta civile” dhe japin të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme.”
44. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet rastit të Gjykatës *KI122/17*, duke shtuar: “Gjykata në këtë Aktgjykim i përcakton dy (2) kriteret të cilat duhet të vlerësohen lidhur me atë se “a mund të mbulohen masat e përkohshme me nenin 6 të KEDNJ-së”. Gjithnjë sipas këtij gjykimi, kushti i parë është (i) kualifikimi i të drejtës në fjalë si “civile”, dhe kushti i dytë (ii) duhet të vlerësohet natyra e masës së përkohshme, se a konsiderohet një masë e tillë e asaj rëndësie që përcakton në mënyrë efektive të drejtën civile ose detyrimin në fjalë.”
45. Parashtruesi i kërkesës thekson se licencat përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike nga ZRRE-ja, bazuar në lejen ujore të dhënë nga MEA-ja përbëjnë “të drejtë civile” në formën e autorizimit për të prodhuar energji elektrike në kuadër të hidrocentralit ekzistues në Komunën e Shtërpçës dhe për të shitur atë më pas te ndërmarrja shtetërore KOSST. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar rastit të GJEDNJ-së *Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, nr. 49429/99, Aktgjykim i 24 nëntorit 2015, shton se GJEDNJ ka një praktikë të gjerë të cilësimit të “licencës” si e drejtë civile, pasi që licenca ndërthen në vete interesa ekonomike.
46. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se aprovimi apo mosaprovimi i kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit ka ndikim thelbësor në të drejtën e tij civile. Në këtë kontest, parashtruesi i kërkesës shton se “Gjykata Themelore e Prishtinës - Departamenti Administrativ është tejet i ngarkuar me lëndë, me të drejtë, nuk prit

që vendimi lidhur me çështjen kryesore të merret brenda një periudhe prej së paku tre (3) viteve, e cila kohë paraqet kohën mesatare të trajtimit të lëndëve në këtë departament. Në një situatë të tillë, edhe sikur që vendimi përfundimtar të jetë pozitiv për Parashtruesin e Kërkesës, dëmi për parashtruesin e kërkesës “Matkos Group” SHPK tanimë do të ishte i pariparueshëm, ngase krahas dëmit material të shkaktuar, një pezullim kaq i gjatë i veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje, do të rrezikonte seriozisht vet ekzistencën e kësaj Kompanie Andaj, vendimi i gjykatës për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit-Leje ujqore të dhëna nga MEA është vendimtar për mbrojtjen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës.”

47. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i (i) zbatimit të gabuar të ligjit dhe (ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor.

(i) Lidhur me pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit

48. Parashtruesi i kërkesës pohon se është i vetëdijshëm se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit mirëpo pasi që në rastin e tij zbatimi i gabuar i ligjit ka sjellë deri tek shkelja e të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese, Gjykata Kushtetuese duhet të lëshohet në shqyrtimin e gabimeve të Gjykatës Supreme. Për ta mbështetur këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI195/20, duke shtuar se Gjykata Kushtetuese duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vërehet se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar e që mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës, siç pretendon se ka ndodhur në rastin e tij.

49. Parashtruesi i kërkesës konsideron se përmes Aktgjykimit [ARJ nr. 116/2021] Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht të drejtën procedurale meqenëse (a) nuk është plotësuar kushti ligjor për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe (b) nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22 paragrafi 1 i LKA-së për caktimin e masës së përkohshme.

(a) Lidhur me pretendimin për mos-plotësimin e kushtit ligjor për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor

50. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit [ARJ nr. 116/2021] Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht paragrafin 2 të nenit 228 lidhur me paragrafin 2 të nenit 214 të LPK-së në lidhje me nenin 63 të LKA-së. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se “me dispozitën e nenit 228 paragrafi 2 të LPK-së përcaktohet se nuk lejohet revizioni kundër aktvendimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në kontestet në të cilat nuk do të ishte i lejuar revizioni kundër aktgjykimit, ndera me nenin 214 paragrafi 2 të LPK-së përcaktohet se Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.”

51. Për të mbështetur pretendimin e tij, parashtruesi i kërkesës rikujton se në Aktgjykimin e kontestuar Gjykata Supreme kishte vlerësuar se në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ishin ofruar dëshmi të besueshme se me ekzekutimin e vendimit të atakuar, para se të vlerësohet ligjshmëria e tij, do të shkactohej dëm vështirë i pariparueshëm dhe se shtyrja ekzekutimit të vendimit ishte në interes publik. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se nga arsytimi i mësipërm i Gjykatës Supreme vërtetohet se vendimi është nxjerrë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe jo për shkak të shkeljes së ligjit

material apo procedural, duke vendosur kështu për një kërkesë për të cilën nuk kishte autorizim ligjor.

(b) *Lidhur me pretendimin se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i nenit 22 i LKA-së për caktimin e masës së përkohshme*

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk plotësohen kushtet nga paragrafi 1 i nenit 22 të LKA-së për caktimin e masës së përkohshme.
53. Parashtruesi i kërkesës thekson se për aprovimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në kuptimin e LKA-së duhet të plotësohen 3 (tri) kushte: (i) me ekzekutimin e vendimit paditësit do t'i shkaktohej dëm që vështirë do të riparohej; (ii) shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik; (iii) shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare apo personit të interesuar.
54. Lidhur me kushtin e parë, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Themelore nuk i janë referuar ndonjë prove materiale me të cilën do të dëshmohej pretendimi i paditësve për dëmin e pariparueshëm që do t'u shkaktohej dhe se në çfarë mase i shkaktohet dëm i pariparueshëm florës dhe faunës, qasjes në ujë të pijshëm, peizazhit natyror dhe turizmit. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykata e shkallës së parë është dashur që të caktojë seancë dëgjimore në të cilën do të vërtetohej drejtë se a do të shkaktonte shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar dëm të pariparueshëm për paditësit dhe se a ishte shtyrja në interes publik.
55. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata e shkallës së parë duhej të merrte parasysh faktin se leja dhe licencat përkatëse për ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike i lëshojnë institucionet dhe organet kompetente të cilat me ligj janë të detyruara që me rastin e lëshimit të tyre të kujdesen për mbrojtjen e natyrës dhe interesit publik.
56. Përkitazi me kushtin e dytë, parashtruesi i kërkesës pretendon se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të MEA-së është në kundërshtim me interesin e përgjithshëm ngase parashtruesi i kërkesës i posedon të gjitha vendimet, lejet dhe licencat me të cilat ka marrë për obligim që me rastin e prodhimit të energjisë elektrike t'iu përmbahet kushteve për mbrojtjen e ambientit, ujit dhe kushteve të tjera të përcaktuara sipas kornizës ligjore të Kosovës. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar ndikon negativisht në zhvillimin e sektorit të energjisë dhe në klimën e investimeve për zhvillimin e gjeneratës së re të kapaciteteve të gjenerimit nga burimet e ripërtitshme. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës shton se iniciativat për investime të huaja në sektorin e energjisë së gjelbër në Kosovë do të pengohen, me çka dëmtohet substancialisht interesi i përgjithshëm publik në Kosovë.
57. Parashtruesi i kërkesës pretendon se as kushti i tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar të MEA-së nuk është përmbushur. Parashtruesi i kërkesës thekson se është kompani në kuadër të cilës funksionojnë edhe 4 (katër) kompani tjera me aktivitet kryesor prodhimin e energjisë elektrike të ripërtitshme, një nga të cilat është Kompania HC Brezovica dhe se si një nga investitorët më të mëdhenj në Kosovë ka investuar më shumë se 25 milion Euro në krijimin e infrastrukturës së nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtitshme.
58. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Prandaj, ne rast se vendimi i Gjykatës Supreme mbetet në fuqi deri në vendosjen meritore të kërkesës kryesore, parashtruesit të kërkesës do t'i shkaktohet dëm i madh dhe i pariparueshëm*

material nga humbjet ne prodhimin e energjisë, si dhe dem jo-material ndaj reputacionit te tij. Humbjet ne prodhim të energjisë kalkulohen bazuar ne shifrat e përgjithshme te prodhimit, ndërsa demi jo-material ndaj reputacionit si një investitor i njohur i kalon shifrat e demit material.”

(ii) *Lidhur me pretendimin për mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor*

59. Parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.
60. Parashtruesi i kërkesës pretendon se meqenëse Gjykata Supreme ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit, e njëjta ka qenë e detyruar që të arsyetojë në detaje vendimin e saj për caktimin e masës së përkohshme, duke i saktësuar qartë arsyet për faktet vendimtare dhe provat materiale në të cilat ka mbështetur konstatimet e saj.
61. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar thëniet dhe argumentet e tij mirëpo ka përdorur një arsyetim shabllon në një paragraf si në vijim: *“Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit-propozuesit me padi dhe me kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor kanë ofruar dëshmi të besueshme se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur para se të vlerësohet ligjshmëria e tij do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohet dhe do të ishte në interes publik shtyrja e vendimit të organit të paditur. Gjithashtu kolegji vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për investim material me ndërtimin e hidrocentralit dhe nëse do të vendosej ndryshe me vendosjen meritore të çështjes do të ishte i vështirë rikuperimi dhe evitimi i dëmeve. Prandaj shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur gjer në vendosjen meritore me vendim përfundimtar, nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi, dhe palës kundërshtare apo palës së interesuar nuk provohet se do të shkaktohet dëm i madh apo i pa riparueshëm.”*
62. Duke iu referuar paragrafit të mësipërm, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme nuk ka bërë asnjë referencë se cilat janë faktet e vërtetuara, cilat janë provat të cilat vërtetojnë ato fakte, si vërtetohet dëmi që do t’iu shkaktohet qytetarëve dhe cilëve qytetarë po iu shkaktohet dëm. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme duke mos trajtuar fare çështjet e faktit dhe të ligjit si dhe argumentet e parashtruesit të kërkesës, ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
63. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se paditësit në kërkesën e tyre për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kanë dështuar që të argumentojnë se janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MEA-së në kuptim të LKA-së si dhe Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për plotësimin e këtyre kushteve.
64. Parashtruesi i kërkesës thekson se është obligim i gjykatave që të vlerësojnë në mënyrë të paanshme pretendimet e të gjitha palëve, gjë që sipas tij nuk ka ndodhur në rastin e tij. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se me rast të rivendosjes dhe pasi që parashtruesi i kërkesës është paraqitur si palë e interesuar, Gjykata Themelore është dashur që të caktojë seancë dëgjimore para se të nxjerrë Aktvendimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MEA-së. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Supreme, në mungesë të argumenteve dhe provave për ekzistimin e rrezikut, është dashur që çështjen ta kthejë në rigjykim me detyrim të caktimit të seancës dëgjimore në të cilën do të paraqiteshin argumentet për të vërtetuar ekzistimin e rrezikut, posaçërisht duke marrë parasysh se Gjykata

Themelore gjatë tërë zhvillimit të procedurës ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 107 të LPK-së në lidhje me nenin 63 të LKA-së, pasi që asnjë vendim të saj apo të gjykatave më të larta nuk ia ka dërguar personit të autorizuar me prokurë të palës së interesuar dhe në këtë mënyrë nuk i është dhënë mundësia që me kohë të njoftohet për përmbajtjen e vendimeve.

65. Më tej, parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme bie ndesh me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së Supreme pasi që nuk i përmbushë kriteret minimale të një arsyetimi të një vendimi. Parashtruesi i kërkesës thekson se përmes një arsyetimi të pamjaftueshëm Gjykata Supreme ka vepruar me mospërfillje shqetësuese ndaj argumenteve të parashtruesit të kërkesës. Sipas parashtruesit të kërkesës, pasojat ligjore në rastet e arsyetimit të mangët sjellin deri tek shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar pikës n), paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së pretendon se Gjykata Supreme nuk ka e marrë mundin për të argumentuar asnjë nga faktet vendimtare apo për të cituar ndonjë nga provat materiale në të cilat ka mbështetur konstatimet e saj.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

66. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme me të cilin është shtyrë ekzekutimi i vendimit të MEA-së paraqet ndërhyrje në të drejtën e tij në pronë.
67. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh të gjitha aktet juridike dhe normat imperative, fundamentale që ato përmbajnë në lidhje me të drejtën në pronë e sidomos përcaktimin e Kushtetutës në lidhje me këtë të drejtë, shihet qartë se e drejta në pronë është e drejtë fundamentale dhe e pacenueshme e njeriut. Kjo shihet edhe nga fakti se në Kushtetutë, e drejta në pronë është vënë në pjesën ku gjenden të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
68. Tutje, parashtruesi i kërkesës i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke theksuar se koncepti i pronësisë nuk përfshin vetëm pronën dhe të drejtën mbi të në kuptim material dhe klasik të fjalës, por përfshinë një gamë të gjerë të të drejtave monetare-të drejta që rrjedhin nga, ndër të tjera, licencat e po ashtu edhe të drejtat që rrjedhin nga drejtimi i një biznesi. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës shton se *“Madje, duke shkuar edhe më larg, në Pressos Compania Naviera SA et al V. Belgium, GJEDNJ përfundoi se edhe një kërkesë për kompensim mund të konsiderohet si aset - në kuptim të pasurisë dhe gëzon mbrojtje sipas Nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së kur provohet mjaftueshëm nga pala se ekziston pritja legjitime që një kërkesë e tillë mund të realizohet.”*
69. Përkitazi me pritjen legjitime, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Rrjedhimisht, ne linje me praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së -pajisja me leje ujore rrjedhimisht udhëzon edhe me të drejtën e pajisjes me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga ZRRE, - për të ushtruar këtë veprimtari ekonomike sipas kushteve ligjore të përcaktuara (në këtë rast sipas kriterëve të parapara në legjislacionin relevant) përben aset në kuptimin e pasurisë që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike. Duke pasë parasysh pritjet legjitime - ngase ata kishin një pritje legjitime që afaronin në përputhje me Ligjin pasi që vetë shteti i kishte garantuar se në rast se ata i plotësonin kushtet ligjore (licencohen), atyre do t'u garantohet veprimtaria e papenguar - atëherë kjo pritje legjitime e tij gëzon mbrojtje sipas Nenit 46 të Kushtetutës lidhur me Nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ.”*

70. Parashtruesi i kërkesës thekson se leja ujore që i është dhënë parashtruesit të kërkesës nga MEA është esenciale për aktivitetin e kësaj kompanie, ngase në momentin e zbatimit të një vendimi gjyqësor me të cilin ndalohet përkohësisht operimi mbi bazën e asaj licence, kompania është detyruar të ndalojë në tërësi veprimtarinë e saj deri në vendosjen meritore të çështjes nga gjykata, që marrë parasysh mbingarkesën e gjykatave me lëndë, një vendim meritore për çështjen në fjalë pritet të merret pas më shumë se 3 (tre) viteve.
71. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton: *“Për të vërtetuar dëmin që i shkaktohet Parashtruesit të Kërkesës mjafton vetëm të shikohet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme për vitet 2019-2020 nga ana e këtij të fundit. Sipas vet raporteve të KOSTT, energjia elektrike e prodhuar dhe e lëshuar në rrjet nga ana e Parashtruesit të Kërkesës për vitin 2019 është 3, 672.5 MWh energji elektrike, nga gjithsej 191, 700 MWh të prodhuara nga burimet e ripërtërishme në Kosovë. Poashtu, për vitin 2020 (si vit i pandemisë) Parashtruesi i Kërkesës ka prodhuar 4, 389.32 MWh energji të pastër elektrike. Këto të dhëna dëshmojnë se Parashtruesi i Kërkesës me pamundësinë e prodhimit të energjisë elektrike do t'i shkaktohet dëm jashtëzakonisht i madh.”*
72. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përveç që dëmi është i madh në kuptimin monetar, i njëjti po ashtu është i pariparueshëm. Parashtruesi i kërkesës thekson se tek korporatat multinacionale struktura e financimit dhe instrumentet financiare për financimin e projekteve investuese është e komplikuar. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se në rast se nuk fillohet me kthimin e mjeteve të investuara për një periudhë të gjatë, kjo do të rezultonte në pamundësinë financiare për të mbijetuar dhe parashtruesit të kërkesës do t'i kanosej seriozisht likuidimi.
73. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se në rastin e GJEDNJ-së, *Lonroth kundër Suedisë*, nr. 7151/75 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, GJEDNJ ka vendosur 3 (tri) parime lidhur me intervenimin/kufizimin e të drejtës në pronës si në vijim: (i) parimi i ligjshmërisë; (ii) parimi i ekzistimit të qëllimit legjitim në mbrojtjen e interesit publik; dhe (iii) parimi i një baraspeshe të drejtë në mes të mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtës në pronë të një personi të caktuar (proporcionaliteti).
74. Duke iu referuar rastit të GJEDNJ-së, *Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, parashtruesi i kërkesës shton: *“GJEDNJ në rastin Capital Bank AD kundër Bullgarisë, Nr. 49429/99, ka gjetur se kriteri i ligjshmërisë, supozon, ndër të tjera që ligji vendor duhet të ofroj mekanizëm për mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga ana e autoriteteve publike. Më tutje, Gjykata thekson se “koncepti i ligjshmërisë dhe i sundimit të ligjit në shoqëri demokratike kërkon që masat të cilat afektojnë të drejtat e njeriut, të mund të jenë objekt shqyrtimi para organeve të pavarura gjyqësore”. Andaj, sipas GJEDNJ-së, “çdo ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës duhet të përcjellët me garanci procedurale që i mundësojnë individëve apo subjekteve juridike që të prezantojnë rastin e tyre para autoriteteve përgjegjëse në mënyrë që të sfidojnë seriozisht hapat me të cilat është ndërhyrë në të drejtat e garantuara sipas kësaj dispozite.”*
75. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 119 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që obligon Republikën e Kosovës që të promovojë mirëqenie dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm sepse *“Marrë parasysh kapacitetet energjetike ekzistuese të Republikës së Kosovës, dhe faktin se përveç mungesës së theksuar të kapaciteteve prodhuese, edhe kriza globale energjetike, dhe rritja enorme e çmimeve të importit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 119, paragrafi 4, pasi që ky Aktgjykim dekurajon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.”*

76. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe mungesën e arsytimit bindës të Gjykatës Supreme, nuk ka pasur garanci të mjaftueshme ndaj arbitraritetit të Gjykatës Supreme çka ka rezultuar me shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

III. Lidhur me pretendimin për caktim të masës së përkohshme

77. Parashtruesi i kërkesës pretendon se zbatimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme do të shkaktojë dëm të pariparueshëm material, pasi që ai do të privohet nga e drejta në ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme bazuar në licencat e dhëna nga organet administrative, pa iu ofruar atij në çështjen e konfliktit administrativ një procedurë e drejtë që i garantohet me Kushtetutë, duke e vënë në pikëpyetje sigurinë juridike për të gjithë qytetarët.

78. Parashtruesi thekson se privimi për disa vite me radhë nga ushtrimi i veprimtarisë së ligjshme bazuar në licencat e dhëna nga organet administrative nuk do të mund të zhbëhet dhe me asnjë dëmshpërblim monetar nuk do të mund të kompensohet demin material dhe jo material që parashtruesi i kërkesës do ta pësonte.

79. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Çmimi për energji elektrike që gjenerohet nga hidrocentralet sipas Vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë V 810/2016, është 67.47 EUR për MWh. Dëmi që i shkaktohet parashtruesit të kërkesës nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar është i pariparueshëm, ngase energjia elektrike që do të mund të prodhohej në këtë periudhë kohore, nuk mund të zëvendësohet me energjinë elektrike e cila do të prodhohet në të ardhmen. Thënë thjeshtë, fitimi që do të mund të realizohej nga gjenerimi-e rrjedhimisht shitja e energjisë elektrike nga ana e Parashtruesit të Kërkesës për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) nuk mund të kompensohet nëpërmjet një prodhimi më të madh që do të mund të ndodhte në të ardhmen.”*

80. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në kundërshtim edhe me interesin publik në Republikën e Kosovës dhe që sjellë pasojë “substancialisht” të dëmshme sepse afekton negativisht klimën e investimeve për zhvillimin e gjeneratës së re të kapaciteteve të gjenerimit të Kosovës. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës shton: *“[...] është fakt se kërkesa për energji elektrike në Kosovë është në rritje e sipër derisa kapacitetet gjeneruese mbeten të njëjta dhe për më tepër ato do të zvogëlohen pas vitit 2023, kur edhe parashikohet dekomisionimi i termocentralit Kosova A.”*

81. Duke iu referuar nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-2020 për Investimet e Huaja, që flet për të drejtën e investitorëve që t’iu drejtohen gjykatave për kompensim të dëmit në rast të shkeljes së ligjit në dëm të tyre, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Rasti në fjalë është duke u vëzhguar me kujdes nga investitorë të mëdhenjë nga e gjithë Evropa. Nëse përfundon në arbitrazh, kjo do të dërgojë një sinjal katastrofik për investitorët e huaj potencial në të gjithë botën. Një gjë e tillë e konfirmon përshtypjen që në Kosovë nuk ka siguri juridike për investitor serioz.”*

82. Lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata : që të vendosë masën e përkohshme në kohëzgjatjen e caktuar nga Gjykata si dhe të suspendojë menjëherë zbatimin e Aktgjykimit [ARJ. nr. 116/2021] të Gjykatës Supreme dhe Aktvendimit [AR. nr. 472/21] të Gjykatës Themelore.

83. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së; (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore [AR. nr. 472/21] e 17 qershorit 2021; (v) të kthejë për rishqyrtim Aktvendimin e Gjykatës Themelore [AR. nr. 472/21] e 17 qershorit 2021 në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese; dhe (vi) të lejojë masën e përkohshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës të rivendosë për çështjen.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

[...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E Drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

LIGJI NR. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 6 Parimi i shqyrtimit verbal

Në konfliktin administrativ, gjykata vendosë në bazë të shqyrtimit verbal, të drejtpërdrejt dhe publik.

Neni 21 [Pa titull]

Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Neni 22 [Pa titull]

2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

[...]

6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

84. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
85. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës, paragrafi 4
“[...]”

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës, paragrafët 1 dhe 7

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]”

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

86. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

87. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës, KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsver brand*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
88. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. nr. 116/2021] e 28 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
89. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, duke marrë parasysh që vendimet e kontestuara ndërliidhen me vendime përkitazi me masa të sigurisë, përkatësisht “*procedura paraprake*”, Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), duhet të vlerësojë aplikueshmërinë e garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
90. Prandaj, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit, është i rëndësishëm sepse procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta hyjnë në fushëveprimin e “*procedurave paraprake*”, përkatësisht Aktgjykimin i kontestuar i Gjykatës Supreme ndërliidhet me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit për leje ujore të lëshuar nga MEA-ja, derisa padia për anulimin e vendimit të MEA-së derisa gjykata themelore të vendos me vendim përfundimtar (shqyrtim të meritave) lidhur me padinë e palëve paditëse. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.
91. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
92. Gjykata vë po ashtu në pah, se kriteret për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me procedurat paraprake janë përcaktuar po ashtu edhe në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI122/17, të cituar më lart; KI75/21, parashtrues *Abrazen LLC*, “*Energy Development Group Kosova LLC*”, “*Alsi&Co. Kosovë LLC*” dhe “*Building Construction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022; KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 9 nëntorit 2019; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 marsit 2020; dhe KI195/20, cituar më lart. Parimet e përgjithshme të vendosura përmes vendimeve të lartcekura të Gjykatës janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart.

93. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse në rastin konkret aplikohet neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do t'iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.
94. Bazuar në praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë apo masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në “*proceduarat paraprake*” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).
95. Sipas kriterëve të përcaktuar në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kriterë edhe kjo Gjykatë i pranoi përmes praktikës gjyqësore, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë “civile” si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe; së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, të cituar më lart, paragrafët 84-85; si dhe rastet e Gjykatës, *KI122/17*, cituar më lart, paragrafët 130-131; *KI81/19*, cituar më lart, paragrafët 47-48; dhe *KI107/19*, cituar më lart, paragrafi 53).
96. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit para nesh parashtruesi i kërkesës i referohet vendimit për leje ujore të lëshuar nga MEA që ndërlidhet me ndërtimin e hidrocentraleve dhe strukturave të tyre mbështetëse në territorin e komunës së Shtërpçës. GLPS dhe Organizata GAIA kishin iniciuar konflikt administrativ duke parashtruar padi ndaj MEA-së ku së bashku me këtë padi, kishin parashtruar edhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar të MEA-së me arsyetimin se hidrocentralet e ndërtuara në territorin e komunës së Shtërpçës kanë ndikim negativ në florë, faunë dhe peisazhin natyror. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të MEA-së si masë e përkohshme bazuar në dispozitat e LKA-së do të nënkuptonte ndërprerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga parashtruesi i kërkesës “MATKOS Group”, deri në marrjen e vendimit meritore lidhur me çështjen nga Gjykata Themelore.
97. Rrjedhimisht, kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, si në rrethanat e rastit konkret, në procedurë të konfliktit administrativ është paraparë me nenin 22 të LKA-së. Ky vendim për shtyrje të ekzekutimit, bazuar në ligjin e aplikueshëm, mund të merret deri në vendosjen në merita të rastit nga gjykatat e rregullta.
98. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte i pajisur me leje përkatëse ujore nga MEA që ndërlidhej me shfrytëzimin e potencialit hidroenergjetik në segmentin lumor të lumit Lepenc për funksionimin e hidrocentralit Brezovica si burim i ripërtërishëm për prodhimin e energjisë elektrike në territorin e komunës së Shtërpçës.
99. Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës (i) gëzon një të “drejtë civile” që vë në lëvizje garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën; dhe, se (iii) garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshme në rastin e tij.

100. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si rezultat, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita (shih rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, Aktgjykim i 7 shkurtit 2012, paragrafi 144; dhe rastin e Gjykatës, *KI27/20*, parashtrues *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).

Meritat e kërkesës

101. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6(E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 (Mbrotjtja e pronës) të KEDNJ-së.
102. Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike përmes hidrocentralit HC Brezovica të ndërtuar në luginën e lumit Lepenc, bazuar në vendimin për leje ujore të lëshuar nga MEA. GLPS dhe Organizata GAIA parashtruan padi kundër MEA-së për anulimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të MEA-së për leje ujore për HC Brezovica, deri në nxjerrje të vendimit meritator nga Gjykata Themelore. Gjykata Themelore e aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve dhe vendosi që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të MEA-së, derisa Gjykata Themelore të vendos me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e palës paditëse. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit parashtrësë që në cilësi të palës së interesuar të hyjë në konfliktin administrativ e më pas edhe ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore. Ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kishte paraqitur edhe Ministria e Drejtësisë. Gjykata e Apelit i miratoi si të bazuara ankesat e MEA-së dhe parashtruesit të kërkesës, dhe anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke i kthyer lëndën kësaj të fundit në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Themelore fillimisht vendosi që të aprovojë propozimin e parashtruesit të kërkesës për njohjen e cilësisë së palës së interesit. Ndërsa, në një datë tjetër, përmes Aktvendimit vendosi që sërish të aprovojë të bazuar propozimin e palës paditëse si dhe të shtyjë ekzekutimin e vendimit të MEA-së derisa Gjykata Themelore të vendosë me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e palës paditëse. Parashtruesi i kërkesës dhe MEA-ja përsëri paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit i aprovoi si të bazuara ankesat e tyre, ndërsa ndryshoi aktvendimin e Gjykatës Themelore duke refuzuar propozimin e palës paditëse për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MEA-së me të cilin i ishte aprovuar leja ujore parashtruesit të kërkesës. GLPS dhe GAIA dorëzuan në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe të drejtës materiale, të cilën Gjykata Supreme e aprovoi si të bazuar duke e prishur Aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe lënë në fuqi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
103. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si rezultat i (i) zbatimit arbitrar të ligjit dhe vlerësimit arbitrar të fakteve lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së në rrethanat e rastit të tij si dhe lidhur me plotësimin e kushtit ligjor për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor; dhe (ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme. Përveç pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon edhe shkelje të nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.

104. Gjykata në kuadër të këtij aktgjykimi, si rezultat i ndërlidhjes së çështjeve të ngjashme, pretendimin për zbatim arbitrar të nenit 22 të LKA-së do ta vlerësojë në kuadër të së drejtës për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
105. Gjatë vlerësimit të meritave të këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

106. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, nr. 12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 20124/92, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë shtjelluar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *KI22/16*, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; *KI97/16*, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; *KI143/16*, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; *KI87/18*, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe *KI230/19*, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
107. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastet e Gjykatës, *KI230/19*, cituar më lart, paragrafi 139 dhe *KI87/18*, cituar më lart, paragrafi 44). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmërimë të madhe të vendimeve (shih rastin e GJEDNJ-së, *Magnin kundër Francës*, nr. 16574/08, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29).
108. Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konstaton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritave dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës, *KI72/12*, parashtrues, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; dhe *KI135/14*, *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

109. Praktika gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse (shih rastet e GJEDNJ-së, Suominen kundër Finlandës, cituar më lart, paragrafi 36; Carmel Saliba kundër Maltës, nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73; dhe shih rastin e Gjykatës, KI227/19, parashtrues *N.T. "SpahiaPetrol"*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2020, paragrafi 46). Për më tepër, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së, Hirvisaari kundër Finlandës, cituar më lart, paragrafi 30).
110. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të drejtë të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih rastet e GJEDNJ-së, Garcia Ruiz kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 29; Hiro Balani kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe Higgins dhe të tjerët kundër Francës, paragrafi 42, si dhe shih rastet e Gjykatës, KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI87/18, *IF Skadeforsikring*, cituar më lart, paragrafi 48).
111. Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin e GJEDNJ-së, Moreira Ferreira kundër Portugalisë, nr. 19808/08, Aktgjykimi 5 korrikut 2011 paragrafi 84; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 137).
112. Një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme (shih rastin e GJEDNJ-së, Tatishvili kundër Rusisë, cituar më lart, paragrafi 62; dhe shih rastin e Gjykatës, KI227/19, cituar më lart, paragrafi 47).
113. Andaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me: (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih rastet e GJEDNJ-së, Buzescu kundër Rumanisë, cituar më lart, paragrafi 67; dhe Donadze kundër Gjeorgjisë, nr. 74644/01, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së, Ruiz Torija kundër Spanjës, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 30; dhe Hiro Balani kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e GJEDNJ-së, Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut, nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96; dhe shih rastin e Gjykatës, KI227/19, cituar më lart, paragrafi 48).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

114. Gjykata rikujton edhe njëherë se thelbi i rastit që ngërthen kjo kërkesë ndërlidhet me një Vendim të MEA-së me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte aprovuar leja ujore

për HC Brezovica, për shfrytëzim të potencialit hidroenergjetik në segmentin lumor të lumit Lepenc. GLPS dhe Organizata GAIA dorëzuan padi për anulimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi në Gjykatën Themelore, ku kjo e fundit e aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve dhe vendosi që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të MEA-së, derisa Gjykata Themelore të vendos me vendim përfundimtar. Në shkallë të dytë, Gjykata e Apelit i miratoi si të bazuara ankesat e MEA-së dhe parashtruesit të kërkesës, dhe anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke i kthyer lëndën kësaj të fundit në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Themelore, në rivendosje, sërish aprovoi si të bazuar propozimin e palës paditëse dhe shtyu ekzekutimin e vendimit të MEA-së derisa Gjykata Themelore të vendosë me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e palës paditëse. Parashtruesi i kërkesës dhe MEA-ja përsëri paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit i aprovoi si të bazuara ankesat e tyre, ndërsa ndryshoi aktvendimin e Gjykatës Themelore duke refuzuar propozimin e palës paditëse për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MEA-së me të cilin i ishte aprovuar leja ujore parashtruesit të kërkesës. GLPS dhe GAIA dorëzuan në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, kërkesë të cilën Gjykata Supreme e aprovoi si të bazuar duke e prishur Aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe lënë në fuqi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

115. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës pretendon në thelb shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor dhe zbatimit arbitrar të ligjit në interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së.
116. Lidhur me pretendimin për zbatim arbitrar të nenit 22 të LKA-së dhe shkelje të së drejtës për një vendim të arsytuar, Gjykata rikujton kushtet ligjore që duhet plotësuar për shtyrjen e ekzekutimit të një akti deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas nenit 22, paragrafi 2 të LKA-së i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.”*
117. Gjykata vëren se sipas dispozitave relevante të cekura më lart, për shtyrjen e ekzekutimit të një akti, është e nevojshme të plotësohen këto kushte:
- i) nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse;
 - ii) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe
 - iii) as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
118. Në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në fjalë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [A. nr. 472/2021] kishte theksuar se *“...Gjykata vlerësoi se paditësit/propozuesit kanë ofruar argumente të besueshme, dhe atë fotot të protestave të mbajtura ndër vite të qytetarëve lidhur me mos ndërtimin e hidrocentralit, foto të dëmtimit të natyrës, raporte të organizatave lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve, të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm banoreve të pjesës në të cilën parashihet të operojnë këto Hidrocentrale, dëm ky i cili vështirë do të riparohej. Gjithashtu Gjykata gjeti se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim dhe nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar.*

Meqenëse burimet ujore, qasja e pandërprerë në ujë të pijshëm dhe për ujitje si dhe cilësia e ujit, ndikimet negative në vlerat e përgjithshme natyrore, në flore në faunë ujore dhe tokësore, në peisazhe përbëjnë interes të përgjithshëm shtetëror, gjykata vlerësoi se shtyerja e ekzekutimit të vendimit të atakuara deri në vendosjen lidhur me padinë e paditësit është në interesin publik e që shtyerja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare në këtë rast ministrisë, e po ashtu personit të interesuar kompanisë "Matkos Group", ngase në këtë rast për të njëjtën shtyerja e ekzekutimit nënkupton vetëm shtyrje të fitimit për më vonë. Kjo do të shmangte pasojat e mundshme që do të shkaktoheshin në të ardhmen, nëse vendimi i kundërshtuar i të paditurës, në fund të procesit gjyqësor, rezulton se është marr në kundërshtim me ligjin."

119. Gjkata gjithashtu rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në Aktvendimin [AA. nr. 665/21], ku duke iu referuar përmbushjes së kushteve për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, konstatoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, duke theksuar si në vijim:

Duke u nisur nga kjo, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se: paditësit - propozuesit në asnjë rrethanë nuk e kanë bërë të besueshëm kushtin e parë të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, se cili do të ishte dëmi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë që do t'i shkaktohej paditësve -propozuesve në rast të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, përveç që kanë përmendur faktin se me ekzekutimin e këtij vendimi do të shkaktohej dëm i pariparueshëm pasi që të njëjtëve po u cenohej mjedisi dhe uji i pijshëm nga ndërtimi i termocentraleve, po paprovuar konkretisht me ndonjë provë konkrete, se ne çfarë mase të njëjtëve u reduktohet furnizimi me ujë dhe u cenohet mjedisi."

120. Tutje, Gjkata e Apelit vlerësoi se nuk ishte plotësuar as kushti i dytë, respektivisht se shtyerja e ekzekutimit të vendimit në këtë rast ishte kundër interesit publik dhe i sillte dëm parashtruesit të kërkesës pasi që ai posedonte vendimin për lejen ujore, në bazë të së cilës ka marrë për obligim për shfrytëzimin e potencialit hidroenergjetik sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim. Në këtë drejtim, në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjkata e Apelit theksoi se "Konkretisht nga vendimi i të paditurës nr. 5784118-ZSP të datës 18.09.2020 është vërtetuar fakti se pala e interesit juridik "Matkos Group" sh.p.k është pajisur me leje ujore kundër tjerash është obliguar të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht të matjeve të niveleve dhe prurjeve të ujit, në profilet përkatëse të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me Lejet Ujore për shfrytëzim të ujit e "nëse për shkak të shfrytëzimit të ujit të hidrocentralit, vije gjer te çrregullimi i regjimit ujqor, gjer te proceset eroduese në shtrat të lumit te objekti ujëmarrës të objektit prodhues dhe përgjatë gyp sjellësit e kjo shkakton dëme të çfarëdo karakteri shfrytëzues i është i obliguar që shkaqet e dëmit ti eliminoj, kurse dëmet ti kompensoj", andaj të njëjtën prove gjykata e vlerësoj të besueshme pasi që në bazë të këtij vendimi e paditura MEA e ka obligim që, të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të kësaj kompania në lidhje me respektimin e kushteve të marruara nga e paditura dhe në rast se ato nuk respektohen të revokoj lejet përkatëse."

121. Në anën tjetër, Gjkata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin [ARJ. nr116/2021], përmes së cilit u vlerësua si jo i drejtë, jo ligjor dhe i mangët qëndrimi juridik i Gjykatës së Apelit lidhur me mos-përmbushjen e kushteve të nenit 22 të LKA-së. Në këtë drejtim, në arsyetimin e Aktgjykimimit të lartcekur u theksua:

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit-propozuesit me padi dhe me kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor kanë ofruar dëshmi të besueshme se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur

para se të vlerësohet ligjshmëria e tij do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej dhe do të ishte në interes publik shtyrja e vendimit të organit të paditur. Gjithashtu kolegji vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për investim material me ndërtimin e hidrocentralit dhe nëse do të vendosej ndryshe me vendosjen meritore të çështjes do të ishte i vështirë rikuperimi dhe evitimi i dëmeve. Prandaj shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur gjer në vendosjen meritore me vendim përfundimtar, nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi, dhe palës kundërshtare apo palës së interesuar nuk provohet se do të shkaktohet dëm i madh apo i pariparueshëm. Gjer sa në anën tjetër do të shmangeshin pasojat e mundshme si do që të vendoset meritorisht gjatë vlerësimit të ligjshmërisë në baza ligjore të vendimit të kontestuar me padi nga paditëset, në fund të procesit gjyqësor.”

122. Lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se me ekzekutimin e vendimit të MEA-së do të shkaktohej dëm vështirë i pariparueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të tij ishte në interes publik dhe se as parashtruesit të kërkesës nuk do t'i shkaktohej dëm i madh apo i pariparueshëm.
123. Për Gjykatën është evidente se mungojnë shpjegime kryesore përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së ndaj rrethanave të rastit konkret sepse: (i) Gjykata Supreme nuk ka peshuar baraspeshën ndërmjet dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktohej palës paditëse karshi dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktohej parashtruesit të kërkesës, duke pasur parasysh investimin e tij në infrastrukturën e hidrocentralit; (ii) pse shtyrja e ekzekutimit të vendimit të MEA-së është në mbrojtje të interesit publik dhe nuk është në mbrojtje të interesit publik nëse do të lejohej ekzekutimi i vendimit të MEA-së duke pasur parasysh se hidrocentrali prodhon energji elektrike të ripërtërishme; (iii) mungon arsytimi shpjegues përse e drejta e GLPS-së dhe organizatës GAIA për mbrojtje nga dëmi i pariparueshëm e mposhtë të drejtën e parashtruesit të kërkesës po ashtu për mbrojtje nga dëmi i pariparueshëm; dhe, (iv) pse interesi i palës paditëse është edhe interes publik dhe përse e njëjta nuk vlen edhe për parashtruesin e kërkesës.
124. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se përtej përshkrimit të dispozitave relevante ligjore për shtyrje të ekzekutimit të një akti siç janë përcaktuar në nenin 22 të LKA-së, Gjykata Supreme, nuk ka shtjelluar asnjë provë apo argument në mbështetje të plotësisht të kriterëve ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MEA-së (shih, rastet e Gjykatës, [KI75/21](#), cituar më lart, paragrafi 86 dhe [KI202/21](#), parashtrues “KELKOS Energy” SH.P.K., Aktgjykim i 29 shtatorit 2022).
125. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është pajisur me leje ujore nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti pëson dëm në vazhdimësi çdo ditë që nuk i lejohet që të ushtrojë veprimtarinë e tij bazuar në lejen që e ka marrë në mënyrë të ligjshme nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës. Më tej, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është nën monitorimin e vazhdueshëm nga MEA në lidhje me respektimin e kushteve të lejes dhe revokimin e saj nëse ato nuk respektohen nga parashtruesi i kërkesës.
126. Gjykata rikujton se GJEDNJ në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka përcaktuar se gjykatat me juridiksion apeli nuk kanë nevojë të japin arsytim të detajuar në rastet kur pajtohen me arsytimin e dhënë gjykatat e instancës së parë, përkundër faktit që të njëjtat po ashtu duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuar (shih rastin e GJEDNJ-sw, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 31).

127. Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka prishur Aktvendimin e Gjykatës së Apelit çka nënkupton se Gjykata Supreme ka pasur për obligim që të ofrojë arsyetim specifik për pretendimet qendrore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe të shtjelluara nga Gjykata e Apelit, dhe jo që t'i shpërfillë ato në tërësi ose që disa prej tyre t'i adresojë vetëm me një arsyetim të shkurtër dhe të përgjithësuar (shih rastin e GJEDNJ-së, Lindner dhe Hammermayer kundër Rumanisë, nr. 35671/97, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2002, paragrafi 33 dhe rastin e Gjykatës, KI202/21, cituar më lart, paragrafi 135). Rrjedhimisht, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme nuk ka mundur që vetëm me një arsyetim të përmbledhur t'i adresojë çështjet thelbësore por ka pasur për obligim që t'i adresojë të gjitha çështjet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, që në rrethanat e rastit konkret nuk ka ndodhur (shih rastin e GJEDNJ-së, Hiro Balani kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 28).
128. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të saj nuk ka shtjelluar se: (i) cili është dëmi që i shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i aktit të kontestuar dhe pse ai dëm është i pariparueshëm; (ii) cilat prova janë vlerësuar për të konstatuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të MEA-së nuk është në kundërshtim me interesin publik; (iii) pse parashtruesit të kërkesës nuk i shkaktohet ndonjë dëm i madh apo i pariparueshëm.
129. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk ka pranuar përgjigje specifike ndaj pretendimeve specifike dhe thelbësore, Gjykata vlerëson se aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i ofron garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së që ngërthejnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, H. kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 53; si dhe shih rastet e Gjykatës, KI202/21, cituar më lart, paragrafi KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, cituar më lart, paragrafi 139 dhe KI87/18, parashtrues IF Skadiforsikring, cituar më lart, paragrafi 44).
130. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme nuk ka gjetur baraspeshën e drejtë (*fair balance*) ndërmjet palëve ndërgjyqëse në këtë procedurë për shkak se nuk ka adresuar asnjë nga pretendimet dhe argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që do të mund ta ndikonin rezultatin përfundimtar të rastit të tij dhe administrimin e drejtë të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, Magomedov dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 33636/09, 34493/09 35940/09 37441/09 38237/0928480/1328506/13, Aktgjykim i 28 marsit 2017, paragrafët 94-95).
131. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të MEA-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, nuk plotëson kriteret e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së. Gjykata po ashtu thekson se Aktvendimi [AA. nr. 665/21] i 30 korrikut 2021 i Gjykatës së Apelit, mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Supreme sipas mënyrës së përcaktuar në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.
132. Gjykata gjithashtu thekson se ky përfundim i referohet shkeljes së pretenduar kushtetuese. Prandaj, Gjykata konstaton se gjetjet e përfshira në këtë aktgjykim në asnjë mënyrë nuk paragjykojnë rezultatin e procedurës lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës.
133. Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës, Gjykata thekson se ky pretendim sipas vlerësimit të Gjykatës është i parakohshëm, ngase para Gjykatës për trajtim janë procedurat paraprake gjyqësore. (shih, rastet e Gjykatës KI75/21, cituar më lart, paragrafi 95 dhe KI202/21, cituar më lart, paragrafi 143).

Kërkesa për masë të përkohshme

134. Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve]

[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

[...]

135. Duke qenë se Gjykata tanimë ka vendosur për meritat e kërkesës dhe ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, vendosja e masës së përkohshme është e panevojshme. Andaj, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21 (4), 113 (1) dhe (7) dhe 116 (2) të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 57 (5) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021 ;
- IV. TË KTHEJË, për rishqyrtim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [AA. nr. 665/21] i 30 korrikut 2021, mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Supreme sipas pikës IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi;
- VI. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- VII. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 13 qershor 2023, për masat e ndërmarra për zbatimin këtij Aktgjykimi;
- VIII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- IX. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- X. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Çaka-Nimani